REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E MEDIAS

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

DREJTUAR BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE TË INTERESUARA.

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.8743, datë 22.01.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", VKM-së nr nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit, e të ish-komunave/bashkive"**,** Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimin publik, si ***dhe shkresës nr.7644/2 prot., date 06.10.2026 të Ministrisë së Mbrojtjes,*** Bashkia Kamëz njofton zhvillimin e një dëgjese publike në kuadër të procesit të konsultimit publik për projektaktin me objekt:

Titulli i Projektaktit që hapet për Konsultim Publik:

"Për dhënien e pëlqimit për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Bashkia Kamëz, te Ministria e Mbrojtjes, të pasurisë me sipërfaqes 12151.2 m², pjesë e pasurisë nr. 1444/54, zona kadastrale 1066, e llojit "Pyll", sipas kërkesës nr.7644/2 prot., date 06.10.2026 të Ministrisë së Mbrojtjes.

- Dëgjesa publike drejtohet nga Administratori i Njësisë Administrative Paskuqan, z.Eduard Bodini.

Në vijim të këtij procesi, ftohen të marrin pjesë të gjithë qytetarët, banorët e zonës, përfaqësuesit e institucioneve vendore, shoqërisë civile dhe çdo grup apo individ i interesuar, me qëllim garantimin e një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje aktive të komunitetit.

Dëgjesa publike do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Datë: 17.11.2026

Ora: 10:00

Vendi: Rruga "Sado Kosheno", Babrru Kodër, Njësia Administrative Paskuqan.

Qëllimi i dëgjesës është informimi i publikut dhe marrja në shqyrtim e komenteve, mendimeve dhe sugjerimeve lidhur me veprimtarinë e propozuar, në kuadër të procedurës për dhënien e pëlqimit për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Bashkia Kamëz, te Ministria e Mbrojtjes, të pasurisë me sipërfaqes 12151.2 m², pjesë e pasurisë nr. 1444/54, zona kadastrale, e llojit "Pyll", bazuar në kërkesën nr.7644/2 prot., datë 06.10.2026 të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planit të rilevimit të miratuar nga Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete, të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:

-konsultim.publik@kamza.gov.al

Pranohen rekomandime deri më datën 17.11.2026.

Kjo dëgjesë do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz, Njësitë dhe Lagjet Administrative të Bashkisë Kamëz, Anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Kamëz.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme.